



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 79, Datë 06.04.2018

MBI

**MIRATIMIN E E MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË KA NËNSHKRUAR OSHEE
SH.A ME SHOQËRINË E LICENCUAR NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME
ENERGJI ELEKTRIKE "NOA ENERGY TRADE" SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 20 pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE Sh.a me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike "NOA Energy Trade" sh.p.k,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr 3908/1 Prot., datë 07.03.2018, ka dërguar në ERE "Marrëveshjen për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" nënshkruar midis "OSHEE" sh.a dhe "NOA Energy Trade" sh.p.k. me nr. 3908 Prot., datë 01.03.2018 dhe nr. 58 datë 01.03.2018. me qëllim miratimin nga ERE në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.02.2017, "Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, ka licencuar shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për një afat 30 – vjeçar.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 8, datë 02.02.2015, ka licencuar shoqërinë "NOA Energy Trade" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5 - vjeçar.

- Bordi i ERE me vendimin nr. 24, datë 15.02.2017, ka miratuar “Marreveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”.
- Në nenin 20 pika 1 të “Marreveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike” sanksionohet se: “*Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE*”.
- Në përmbajtjen e saj, kjo marrëveshje e nënshkruar dhe dakortësuar mes palëve ka reflektuar saktësisht të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen tip të cilën e ka miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 24, datë 15.02.2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të miratojë marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 3908 Prot., datë 01.03.2018 dhe nr. 58 datë 01.03.2018, nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a dhe shoqërisë NOA Energy Trade sh.p.k.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.